

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“IONIAN DREAMS” SH.P.K**

Neni 1

**Emërtimi i shoqerise**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “**IONIAN DREAMS**” shpk e krijuar nga ortaket:

Odeta Haxhi shqiptare i datelindjes 12/06/1963 me mjet identifikimi G35612041S me pergjegjesi te plote e juridike per te vepruar

Hari Dogga shqiptar i datelindjes 24/03/1996 me mjet identifikimi J60324070J me pergjegjesi te plote e juridike per te vepruar

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron veprimtarine ne baze te Ligjit Nr.9901 „date 14.04.2008“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Neni 2

**Selia e shoqerise**

Selia e shoqërisë “**IONIAN DREAMS**” shpk është Himare, Lagjja Spile, Rruga Shetitorja, Objekt nr.32. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 3

**Kohëzgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtruje aktivitetin tregtar do te jetë subjekt i te drejtës me një afat te pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut te shoqerise.

Neni 4  
**Objekti**

Objekti i shoqërisë do te jetë si vijon :

Operator turistik, operator turistik detar, guide turistike, agjensi turistike, agjensi turistike detare, ture turistike, levizje me mjete turistike ne det, turizem familjar etj

NENI 5  
**Kapitali i regjistruar**

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar ne shoqëri ështe 100000leke (njeqindmije) , numri i kuotave eshte 2(dy)i ndare sipas kontributeve:

Odetë Haxhi shqiptare i datelindjes 12/06/1963 me mjet identifikimi G35612041S me 1 kuote ne masen 50% me vlere 50000 leke

Hari Dogga shqiptar i datelindjes 24/03/1996 me mjet identifikimi J60324070J me 1 kuote ne masen 50% me vlere 50000 leke

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo te zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te shoqerise .

Neni 6  
**Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të shoqërise “**IONIAN DREAMS**” shpk e të drejtat qërrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit nëkapitalin e shoqërisë;

shitblerjes;

trashëgimisë;

dhurimit

çdo mënyretjetër tëparashikuarme ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet meshkrim.

Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen ne mbledhjen e asamblese te shoqerise ku te drejten e parablerjes e kane ortaket e shoqerise

Neni 7  
**Asambleja e Pergjitheshme e shoqerise**  
**Të drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë përcështjet e mëposhtme:

- përcaktimin epolitikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendurnë shkronjat "c" dhe "ç" tëkësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirëpërgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve tëecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin etyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë nëgjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështjetë tjera të parashikuaranga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuaranë shkronjat "e" dhe "ë" të pikes 1 të këtijeni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentevepërkatës

3. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtepasur dijeni për të.

## Neni 8

### **Mbledhja e asamblesë së përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet epërcaktuaranga ky ligj, nga ligjetë tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshmepër të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshmee asamblesë së përgjithshme thirret tëpaktën një herënë vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton oseekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshmebrenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesëapo të disponojë në mënyrëtjetër aktive, të cilat kanë njëvlerë mëtë lartë se 5 për qind të aseteve tëshoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve tëpara pas regjistrimit të saj, propozon tëblejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtijeni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhebëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm/asambleja e ortakeve.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinëe administratorëve.

#### Neni 9

#### **Mënyra e thirrjes**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi meshkresë ose, nëseparashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresëapo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditëpërpara datës së parashikuarpër mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime tëvlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, përtë marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

#### **Kërkesa nga ortakët e pakicës**

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnëtë paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuarnë statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrurasamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve tëposaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, përtë cilat asambleja duhet të marrë njëvendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtëta thërrasin asamblenë dhetë caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtijneni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuarprejkëtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejëpadi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përm bushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij nenidhe thirrja i është njofuar ortakëve, administratorët njofojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtijligji.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është idetyruar të deklarojë çdo fakt apo rrëthanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarjenepërfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësua

### Neni 11

#### **Përfaqësiminë asamble**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë përgjithshme, në bazë të një autorizimingu një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët eshoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimimund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 12

#### **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtëvote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosëpër çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 tëkëtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit totaltë votave janë të pranishëm personalisht, votojnë meshkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimevetëpikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendurnë pikën 1 tëkëtij nen, asambleja mblidhet përsërijo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 13**  
**Marrja e vendimeve**

1. Me përjashtimtë rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vodos me tritë katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet nëpikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjene fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet etjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vodos meshumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi iortakut përkatës.

**Neni 14**  
**E drejta e votës**

1. Me përjashtimtë rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuotë jep të drejtën enjë vote.
2. Statuti mund tëparashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë sëpërgjithshme memjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimii ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblessësë përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshmenga një vendndodhje tjeter;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes sëmbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përtë marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorimtë jetë proporcional me arritjen e këtyreqëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

### Neni 15

#### **Përjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien osejo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson

### Neni 16

#### **Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbalevetë mbledhjetë asamblesë së përgjithshme.
2. Prosesverbali duhet të përbajëdatën e vendin embledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit etë mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Prosesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetaridhe nga mbajtësi iprocesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar njëfaqe në internet, administratorët, jo më vonëse 15 ditënga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje tëprosesverbalit tëmbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

### Neni 17

#### **Drejtimi dhe administrimit**

Shoqeria tregtare “**IONIAN DREAMS**” shpk do te drejtohet nga një administrator që emerohet me vendim te Asamblese te Shoqerise. Administratori i shoqerise per periudhen 5 vjecare duke filluar nga data e sotme do te jete Ledion Malaj shqiptar i datelindjes 08/03/1990 me mjet identifikimi J00308077C. Administratori ka te drejte e te detyrohet te :

- Kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politika tregtare te vendosur nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.

- Perfaqesoje shoqerine tregtare
- Kujdeset per mbajtjen sakte e te regullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoquerise
- Pergatit dhe nenshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paraqet keto perpara asamblea e përgjithshme e shoquerise per miratim,
- Krijon nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoquerise,
- Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit
- Raporton para asamblese te përgjithshme e shoquerise ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoquerise tregtare,
- Administratori do te shperblehet sipas percaktimit te asamblese se përgjithshme te shoquerise ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 date 14.04.2008.

#### Neni 18

#### **Kontrolli i brendshem**

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendshem me nje ekspert kontabel te regjistruar , i cil eshte perqejges perpara shoquerise per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne regull e detyres se tij

#### Neni 19

#### **Bilancet dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike e financiare te shoquerise do te mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti, pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakeve te shoquerise:

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxiret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim.Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 Mars te viti paseardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe mbetet i jepet per perdonim asamblese se përgjithshme te shoquerise.

#### Neni 20

#### **Shperberja e shoquerise**

Shperberja e shoquerise mund te vije ne cdo kohe dhe cfardo shkaku.Ne rast shkrirje para afatit te shoquerise, Asamblea e përgjithshme e shoquerise vendos mbi menyrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator duke i percaktuar dhe detyrat.

Ne rasti e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "shoperi ne likujdim "

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit "

Neni 21

**Dispozitat perfundimtare**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut do i referohet plotesimeve nga asamblea e përgjithshme e shoqerise.

Shoqeria "**IONIAN DREAMS**" shpk do te jete subjekt i te drejtis shqiptare dhe do ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjisacionit shqiptar ne per gjithesi ,normat e ketij statuti dhe te aktit themelues bashkangjitur .

Ky statut nenshkruehet nga ortaket i shoqerise ne daten 13/05/2024

**Ortaket  
Odetë Haxhi**

**Hati Dogga**

**Administrator**

**Ledion Malaj**

